



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 447 Prot.

Tiranë, më 02.072015

VENDIM Nr. 66 datë 23.06.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.9, të datës 23.06.2015, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Gërmime në Maligrad"* miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Prof. Petrika Lera (IA) dhe Prof. Stravos Oikonomidis (Instituti Marrëdhënive Ndërballkanike Kulturore të Athinës, Greqi),

VENDOSI:

- I. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Gërmime në Maligrad"* paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Prof. Petrika Lera (IA) dhe Prof. Stravos Oikonomidis (Instituti Marrëdhënive Ndërballkanike Kulturore të Athinës, Greqi), në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Vazhdimi i gërmimeve në Sektorin A3, që përfaqëson transhenë gjatësore në anën lindore të platformës së ishullit, ku vitin e kaluar u kapën për herë të parë materiale të periudhës së bronzit të hershëm.
 - Gjurmimi dhe studimi i periudhave historike të antikitetit dhe mesjetës në Sektorin A1 dhe A2, ku janë zbuluar materiale që lidhen me këto periudha.
- II. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë brenda gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2015.
- III. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR

SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rrugë "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: www.asha.gov.al